



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

**PËR ZBATIMIN E MASAVE TË PARASHIKUARA NË
REKOMANDIMET 6, 7, 10, 11 DHE 12 TË BE PËR SHQIPËRINË,
TË CILAT KANË LIDHJE ME FUSHËN E VEPRIMTARISË SË
AVOKATIT TË POPULLIT, SI DHE AKTIVITETI I
INSTITUCIONIT LIDHUR ME KËTO
REKOMANDIME, GJATË PERIUdhËS
JANAR-QERSHOR 2012**

Tiranë, Korrik 2012

Hyrje

Shqipëria, është në një moment të rëndësishëm të procesit të integritimit në Bashkimin Europian, në këtë kuadër institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se reformat që duhet të ndërmerren nga institucionet e shtetit shqiptar, duhet të jenë të përqasura me standardet më të mira ndërkombëtare, duke garantuar në këtë mënyrë zbatimin, e parimeve demokratike të shtetit të së drejtës, dhe të të drejtave të njeriut.

Zbatimi i ligjit në mënyrë të barabartë nga institucionet shtetërore, organet e qeverisjes vendore, si dhe respektimi i parimeve themelore të një shteti demokratik, mendojmë se ndikon drejtpërdrejt në zbatimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe interesave të tyre. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se garanci për këtë do të jetë qeverisja e mirë, e drejtë dhe asnjansë, e orientuar drejt filozofisë së zbatimit të ligjit për të mundësuar funksionim të shoqërisë dhe hapjen e rrugës së zhvillimit.

Përmirësimi dhe thellimi i demokracisë në shoqërinë shqiptare, forcimi i demokracisë institucionale, rritja e nivelit të qeverisjes, kërkon që të gjitha institucionet e shtetit të marrin masat e nevojshme dhe të domosdoshme, institucionale dhe legjislative, të cilat do të garantojnë në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme liritë, të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit është angazhuar të japë kontributin e tij institucional, për çdo iniciativë, analizë apo çështje, që kërkon të zgjerojë apo edhe garantojë hapësirën e individëve për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore në përputhje me, Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi.

Procesi i integritimit në BE, është një proces në të cilin Shqipëria duhet të tregojë vlerat e saj, dhe që meriton të jetë pjesë e familjes europiane. Në këtë kontekst të gjitha institucionet shtetërore dhe institucionet e pavarura kushtetuese kanë rolin dhe përgjegjësinë e tyre për të kontribuar në përputhje me fushën e kompetencës së tyre, në plotësimin e detyrimeve që Shqipëria i janë vendosur gjatë këtij procesi nga institucionet e BE.

Gjatë këtyre 6 muajve Institucioni i Avokatit të Popullit, ka kontribuar në vazhdimësi me nismat, aktivitetet dhe rekomandimet e tij, edhe në drejtim të plotësimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për Zbatimin e 12 Rekomandimeve të BE për Shqipërinë.

Nëpërmjet këtij raporti:

1. është vlerësuar zbatimi i disa masave të cilat janë përcaktuar në disa prej rekomandimeve të BE, si në rekomandimin 6, 7, 10, 11 dhe 12, të cilat kanë lidhje me fushën e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe

2. janë paraqitur disa nga nismat, rekomandimet dhe aktivitetet që ka kryer institucioni ynë në drejtim të plotësimit të këtyre rekomandimeve gjatë muajve janar-qershor 2012.

Në Planin e Veprimit për zbatimin e 12 rekomandimeve të BE për Shqipërinë, për vitin 2012, janë të parashikuara disa masa, të cilat në vlerësimin tonë mund të ndikojnë jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, në garantimin e te drejtave dhe lirive të individit, dhe për rrjedhojë për të cilat nuk ka patur një ndikim apo veprim të institucionit të Avokatit të Popullit. Në raportin në vijim nuk kemi analizuar apo vlerësuar zbatimin e tyre.

Gjithashtu vlen të theksohet, se sipas raporteve të muajve prill dhe maj 2012, të vendosura në faqen zyrtare të Ministrisë së Integritit Europian, për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit për zbatimin e 12 rekomandimeve të BE për Shqipërinë, nuk rezulton se cili është statusi aktual për disa masa (legjislative apo aktivitete zbatuese), pra për to në këto raporte nuk ka asnjë informacion.

I. Rekomandimi 6 “Reforma në administratën publike”:

Në rekomandimin 6, çështjet të cilat janë vlerësuar lidhen me masat ku përcaktohet detyrimi për miratimin e një projektligji të ri “Për statusin e nëpunësit civil”, si dhe për “zbatimin efektiv të kuadrit ligjor ekzistues”.

1. Lidhur me masën 1.2 “projektligji për shërbimin civil”, Institucioni i Avokatit të popullit ka përgatitur komentet dhe vlerësimet për përmbajtjen e projektligjit, të cilat i janë përcjellë edhe zyrtarisht Departamentit të Administratës Publike. Projektligji është konsultuar në disa takime me përfaqësues të institucioneve të cilat janë të përfshira në shërbimin civil, por ende nuk ka filluar procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të tij në Këshillin e Ministrave. Për më tepër lidhur me mendimet e Avokatit të Popullit për këtë projektligj, bashkëngjitur keni një kopje të këtyre mendimeve.

2.Përsa i përket masës 4.2 “Paraqitja e një raporti për zbatimin e vendimeve të KSHC dhe vendimeve të gjykatave për shërbimin civil”.

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit vazhdimisht janë paraqitur ankesa, për moszbatim të legjislacionit dhe procedurave për shërbimin civil, apo edhe për zbatimin e vendimeve gjyqësore për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës. Për këtë çështje, por edhe për problematika të tjera të marrëdhënieve juridike të punës nga organet e tjera të administratës publike, që nuk janë pjesë e shërbimit civil, bazuar në ankesat/kërkesat e paraqitura pranë Avokatit të Popullit, është përgatitur një vlerësim i cili i është përcjellë Departamentit të Administratës Publike (një kopje të të cilit e keni bashkëngjitur).

Sipas këtij vlerësimi, bazuar në trajtimin e ankesave të paraqitura pranë institucionit, apo edhe në pyetsorët e shpërndarë në punonjës të administratës publike vendore, është konstatuar se:

- a.Shkak për largimet nga puna, si për personat që kishin statusin e nëpunësit civil ashtu edhe për ata që trajtoheshin me Kod Pune, në shumicën e rasteve kanë qënë reformat institucionale, ristrukturimi apo edhe motivet politike për t’i lënë vendin personave të tjerë;
- b. Në shumicën e rasteve, kur zgjidhja e marrëdhënieve të punës është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, nuk është respektuar ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt ligjor;
- c.Në shumicën e rasteve ndërhyrjet e strukturave shtetërore nuk kanë munguar, duke u bërë kështu pengesë e duke influencuar në vendimmarrjen e administratave lokale lidhur me personelin në juridiksionin e tyre;
- ç.Në rekrutimin e personelit të administratës shtetërore si për nëpunësit civil ashtu edhe për personelin teknik e ndihmës, nuk merret parasysh kualifikimi i nevojshëm për vëndet përkatëse të punës;
- d. Ka mosrespektim të pikës 3 të nenin 146 të Kodit të Punës, për zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme;
- e. Në shumicën e rasteve, zgjidhjen e kontratës së punës justifikohet me suprimimin e vendeve të punës si rrjedhojë e ristrukturimit të institucionit;
- f. Ka patur largime nga puna për shkak të mospërputhjes të shkallës së arsimit të punëmarrësit me atë të vendit të punës, paaftësinë e përkohshme fizike të punëmarrësit, plotësimin e kushteve për pension etj;
- g. Ka mosrespektim të detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës e për të

cilën punëdhënësi është i detyruar të zbatojë atë, në rastet e punëmarrësve me status të nëpunësit civil;

Bazuar në problematikat e sipërcituara është vlerësuar se është e nevojshme që:

a. Të zbatohen standartet e vendosura nga kuadri ligjor ekzistues që garanton marrëdhëniet e punës, nga ana e administratës publike të të dyja niveleve.

b. Duhet për çdo rast të nxirret e përgjegjësia e drejtuesve të institucioneve (dëmi jashtëkontraktor) të cilët janë shkaktarët e situatave të paligjshmërisë në trajtimin e marrëdhënieve të punës dhe që me veprimet e tyre të parregullta dhe të pabazuara rrisin faturën financiare të detyrimit të shtetit ndaj gjyqfituesve.

c. Të rriten kapacitetet e stafeve të administratës publike, që janë përgjegjëse për ndjekjen e procedurës për largimin nga puna, me qëllim që të realizohet kuptimi dhe zbatimi i drejtë i procedurës së parashikuar në ligj dhe t'u garantohen punëmarrësve të drejtat e sanksionuara.

d. Të miratohen ndryshimet në ligjit “Statusi i Nepunësit civil”, të cilat duhet të shmangin në përmbajtjen e tyre qëndrimet subjektive dhe abuzive në zbatimin e tij.

II. Rekomandimi 7 “Reforma në Gjyqësor”

Vlerësimi dhe kontributi i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë rekomandim është fokusuar në masat të cilat garantojnë aksesin në drejtësi të grupeve vulenarbël, si dhe zbatimin efektiv të vendimeve gjyqësore.

1. Përsa i përket masës 6.1 “Zbatimi efektiv i legjislacionit për ndihmën juridike”, në muajin qershor 2012, është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Komitetit Shtetëror të Ndihmës Juridike. Nëpërmjet kësaj marrëveshje është përcaktuar angazhimi i Komitetit Shtetëror të Ndihmës Juridike, për të vlerësuar dhe trajtuar sipas procedurave ligjore dhe nënligjore, rastet e përcjella nga Avokati i Popullit, me qëllim ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore, grupeve vulnerabël, të cilat plotësojnë kriteret e parashikuara në ligj.

Gjithashtu lidhur me këtë masë, institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me EURALIUS dhe TLAS (organizatë jofitimorurëse) organizuan një tryezë të rumbullakët për të diskutuar lidhur me sfidat për ofrimin e ndihmës juridike falas. Nga diskutimi në tryezë, u konstatua që ka patur zhvillime pozitive në drejtim të miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit, nëpërmjet të cilave janë përcaktuar rregullat për paraqitjen e aplikimit nga individët apo grupimet shoqërore që kërkojnë të përfitojnë, rregullat e caktimit të avokateve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse të cilat do të ofrojnë ndihmen juridike, masën e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmën juridike etj.

Ndër problematikat që Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar dhe vlerësuar për ofrimin e ndihmës juridike, por bazuar edhe në shqetësimet e paraqitura nga organizatat e shoqërisë civile, do të veçonim:

a. Funksionimin efektiv të Komisionit Shtetëror të Ndhimes Juridike për rritjen e numrit të rasteve që ofrohet ndihma juridike parësore apo dytësore.

b. Transparenca është një element shumë i rëndësishëm i parimit të qeverisjes së mire, në këto kontekste, transparenca e veprimtarisë së Komisionit Shtetëror të Ndhimes Juridike lidhur me, vendimarrjen e tij për subjektet që ju miratohet dhënia e ndihmës ose jo, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit për ofrimin e ndihmës juridike, kontratat e lidhura me avokatët dhe organizatat jofitimprurëse që do të ofrojnë shërbimin;

c. Trajtimin si raste me përparësi për dhënie ndihme juridike, të grupeve të tilla si, romët, personave me aftësi të kufizuara, fëmijet, gratë e dhunuara, personat përfitues të ndihmës ekonomike etj, si shtresat shumë më të varfra dhe me nivel të ulët arsimor në shoqëri, të cilat e kanë të pamundur që vetë të realizojnë aksesin në drejtësi;

d. Lehtësimin e procedurave dhe të dokumentacionit që paraqitet për përfitimin e ndihmës juridike, duke shmangur shpenzimet e vetë individit, dhe ndoshta duke parashikuar marrjen e këtij informacioni në mënyrë zyrtare nga vetë Komisioni Shtetëror i Ndhimes Juridike tek autoritetet shtetërore përgjegjëse. Mendojmë se procedurat dhe dokumentacioni kompleks, cenon aksesin por dhe venien e të drejtës në vend;

e.Vendosjen e tarifave ligjore më të favorshme për shpenzimet gjyqësore gjatë dhënies së ndihmës juridike, për këtë kategori individësh apo grupimesh shoqërore;

d.Krijimi i mundësisë për lista të hapura të avokatëve, me qëllim zgjedhjen nga vetë individi të avokatit që do t'i ofrojë ndihmën juridike dhe me tej kalimin e tyre për vendimarrje në Komision. Në këtë mënyrë mendojmë se do të shmanget subjektivizmi dhe abuzivizmi në përzgjedhjen e ofruesve të ndihmës juridike;

e.Monitorimi nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar nga Avokatët apo Organizatat Jofitimprurëse, si një element shumë i rëndësishëm për garantimin dhe dhënien e drejtësisë ndaj cilitdo që pretendon se i është shkelur ajo.

2.Lidhur me masën “Përmirësimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore”

1.Përsa i përket kësaj mase, institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur një raport të veçantë për zbatimin e vendimeve gjyqësore nga organet e administratës publike, si dhe për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Për gjithë rastet e shqyrtuar apo në shqyrtim prej Institucionit të Avokatit të Popullit është konstatuar se mosrespektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj, për palët në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vjen si rezultat i:

- 1- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë dhe objektivitetit, nga ana e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror (ShPGjSh), përmbarruesit gjyqësor të çështjes, parime të cilat janë të sanksionuara në nenin 4 të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor”, i ndryshuar. Shkelja e parimeve në fjalë, në rastin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv me objekt, “Detyrim për pagim në të holla prej institucioneve buxhetore”, apo “Detyrim për kryerjen e një veprimi të caktuar”, vjen si rezultat i : i) Moskryerjes së veprimtarisë nga ana e DShPGjSh dhe atij Privat në përputhje të plotë dhe konsekuente me parashikimet e bëra në nenet 517, paragrafi dytë, 527, 583, 589 dhe 606 të K.Pr.C., ii) Ushtrimi në mënyrë të padrejtë e të parregullt prej zyrave të përmbarrimit, përmbarruesve gjyqësor të çështjes, i së drejtës për të refuzuar

- kryerjen e veprimeve përmbartimore në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv (rasti me nr.doculive 201000697, nr.201000697) pa u ndodhur në kushtet e parashikuara në dispozitën ligjore, neni 610, iii) Pushimi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv (rasti me nr.doculive 201001284, rasti me nr.doculive 201101285, nr. 201100365, nr.201100365) pa u ndodhur në kushtet e parashikuara në dispozitën ligjore, neni 616 të K.Pr.C., iv) Shfaqja e mungesës së aftësive profesionale në procesin e ekzekutimit (rasti me nr. doculive 20100697, nr.201101032, nr.201100802, nr. 201100715, nr.201100365.)
- 2- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të institucioneve buxhetore debitorë apo organeve eprore financiare të tyre, sikurse parashikohet në nenin 531 të K.Pr.C si dhe nenet 20 dhe 21 të Ligjit nr.8510, datë 15.07.1999, *“Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”*, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv.
 - 3- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të degëve të thesarit në rrethe, siç sanksionohet në nenin 581, 583 dhe 589 të K.Pr.C. në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv sipas të cilëve rezultojnë debitor institucione buxhetore.
 - 4- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të palëve të treta (organit shtetëror) në procesin e ekzekutimit, sikurse sanksionuar në nenin 523 të K.Pr.C. (rasti me nr.doculive 201101920)

Në përfundim të analizës në raport është arritur në konkluzionin që:

- Përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë të Përgjithshme të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror për drejtimin dhe kontrollin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, janë minimale.
- Rezulton ekzekutimi i diferencuar i titujve ekzekutivë. Ashtu sikunder është prezantuar në raportt, nga njëra anë KM, nxjerr akte për ekzekutimin e vendimeve të dhëna nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, nga ana tjetër, duhet shprehur i njëjti vullnet në përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga gjykatat shqiptare.
- Janë evidente mangësitë profesionale tek një pjesë e stafit përmbartimor, zvarritje të pajustificuara gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, mungesa e transparencës dhe përkushtimi.
- Ka mungesë bashkëpunimi midis përmbartuesit gjyqësor me organe të tilla si Ministria e Financave, Policia e Shtetit, Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik Vendor apo Kombëtar, organet e

pushtetit vendor etj, mos-sqarim për të drejtat dhe detyrimet e paleve pjesemarrese ne procesin e ekzekutimit dhe me vetë përmbaruesin, fakt që reflekton në cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit.

- Duhet realizuar sa më shpejt unifikimi i praktikave përmbarimore.
- Eshte i nevojshem përmirësimi i infrastrukturës së Shërbimit Përmbarimor Shtetëror.
- Mbetet domosdoshmëri një akt nënligjor për mënyrën dhe afatin maksimal të ekzekutimit të titujve ekzekutive nga organet e shtetit lidhur me detyrimet monetare apo kryerjen e nje veprimi te caktuar(neni 605 i KPrC).
- Krijimi i nje data base per pasqyrimin e te gjitha praktikave permbarimore ku debitore jane institucionet buxhetore.

Një tjetër çështje lidhur me këtë masë dhe për të cilën Avokati i Popullit ka nxjerrë një rekomandim është udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr.2, datë 18.08.2012 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”.

Në vlerësimin që është bërë për këtë akt, është konstatuar që në përmbajtjen e tij, ka përcaktime të cilat:

- a.nuk vijjnë në përputhje me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Civile, për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv,
- b.krijojnë premisa për moszekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm,
- c.tejkalojnë misionin për ekzekutim pranë personit të tretë apo palës debitore.

Për të realizuar përputhshmërinë e këtij akti nënligjor të Këshillit të Ministrave, me dispozitat ligjore që parashikojnë ekzekutimin e detyrimeve në të holla nga institucionet buxhetore, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë, për dijeni Këshillit të Ministrave, ndryshimin e Udhëzimit nr. 02, datë 18.08.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”.

Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 2998/1 Prot, datë 29.05.2012, drejtuar Avokatit të Popullit, bënë të ditur se ka përcjell për kompetencë pranë Ministrisë së Financave rekomandimin e dhënë me shkresën nr. K3/S8-6 Prot, datë 26.03.2012, duke mos dhënë konsiderata lidhur me çështjen e prezantuar në të. Deri në këto momente, Ministria e Financave nuk ka kthyer një përgjigje për pranimin ose mospranimin e

rekomandimit të dhënë prej Avokatit të Popullit, lidhur me ndryshimin e këtij Udhëzimi nr. 02, datë 18.08.2011.

Gjithashtu përsa i përket detyrimit për nxjerrjen e aktin nënligjor nga Ministria e Drejtësisë, sikurse është parashikuar në nenin 573 të K.Pr.C., i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit ka filluar me iniciativë shqyrtimin e kësaj çështje, duke i kërkuar me shkresën nr. K3/M48-2 prot, datë 02.04.2012, Drejtorit të Shërbimit të Përmbaramit Gjyqësor, pranë Ministrisë së Drejtësisë, dhënien e informacionit lidhur me veprimet e mundshme të kryera për nxjerrjen e aktit nënligjor në referim të dispozitës ligjore të sipërcituar. Deri tani, përmbushja e detyrimit për dhënien e informacionit dhe shpjegimeve të kërkuara nuk është realizuar, prej subjektit të lartpërmendur.

III. Rekomandimi 10 “Strategjia dhe plani i veprimit për të drejtat e pronës”

Për këtë rekomandim fokusi ynë ka qenë miratimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të drejtën e pronës, dhe parashikimi në të i detyrimeve të përcaktuara në VKM 350/2011.

1.Në lidhje me Rekomandimin 10 masa 1.1, ku parashikohet hartimi i një draft strategjie mbi të drejtat e pronësisë deri në nëntor 2011 – Aktualisht, Këshilli i Ministrave ka vendosur në mbledhjen e tij të datës 27.06.2012 Miratimin e strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012 - 2020” dhe të planit të saj të veprimit, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Theksojmë se gjatë konsultimit të Draft-Strategjisë, institucionit të Avokatit të Popullit nuk i është kërkuar mendim, me qëllim paraqitjen e problematikave apo propozimeve konkrete për t’u përfshirë, bazuar në ankesat apo kërkesat e trajtuara dhe shqyrtuara në vite nga Institucioni.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar vazhdimisht pranë AKKP-së, përcaktimin përfundimtar të fondit të pasurive të paluajtshme për kompensim fizik të të shpronësuarve, veprim ky i cili nuk është realizuar dhe vështirë që të realizohet për të ardhmen e afërt, kur rreth 20% e trojeve nuk janë futur në sistem (nuk janë dixhitalizuar dhe regjistruar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme). Mendojmë që kompensimi financiar mbetet i vështirë për t’u realizuar, prandaj kompensim fizik do të ishte zgjidhja më e mirë, si për qeverinë ashtu dhe për ish pronarët.

2. Në këtë rekomandim gjithashtu mendojmë se duhet evidentuar në mënyrë të veçantë:

a. shtyrja në kohë e realizimit të detyrimeve të parashikuara në VKM 350/2011, për disa çështje si Agjensia për Prodhimin e Hartave të Standardizuara, metodologjisë me të cilën do të kryhet standardizimi i hartave, përfundimit të disa proceseve të parashikuara në të (ndryshimet e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave etj);

b. problematika e zbatimit të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut (e cila është trajtuar edhe në raportin e veçantë të Avokatit të Popullit për zbatimin e vendimeve gjyqësore).

IV. Rekomandimi 11 “Forcimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut”.

1. Lidhur me masën 11.1.1 “Vendosja e mekanizmit kombëtar të referimit për luftën ndaj viktimave të dhunës në familje”, konstatojmë se Vendimi i Këshillit të Ministrave për vendosjen e këtij mekanizmi ka hyrë në fuqi prej muajit mars 2011. Megjithëse ka kaluar më shumë se një vit nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave, mekanizmat në nivel vendor duhet të ishin ngritur dhe konstituar tashmë. Në këtë mënyrë zbatimi i procedurave për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, do të bëhet nëpërmjet mekanizmave të përcaktuar në VKM, për të gjitha rastet të cilat kanë ndodhur në territorin ku njësia e qeverisjes vendore shtrin juridiksionin e saj.

Përsa i përket viktimavë të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe trajtimin e këtij fenomeni, institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur një raport të veçantë, ku është bërë një vlerësim se:

- a. si ka evoluar ky fenomen në vite në Shqipëri,
- b. cilat janë rregullimet ligjore dhe nënligjore për këtë çështje,
- c. cilat janë mekanizmat qeveritare dhe koordinues që hartojnë politikën, rregullat e posaçme dhe standardet e shërbimeve për trajtimin e viktimave të dhunës,
- d. cilat janë problematikat që janë konstatuar gjatë zbatimit të ligjit për dhunën në marrëdhëniet familjare,
- e. si përmbushen kompetencat respektive nga autoritetet shtetërore përgjegjëse,
- f. nëse organet e qeverisjes vendore kanë respektuar detyrimin për ngritjen e strehëzave të trajtimit të viktimave të dhunës në nivel vendor,
- g. nëse janë ngritur mekanizmat e referimit të rasteve të viktimave të dhunës në nivel vendor.

Në përfundim të vlerësimit të kryer në këtë raport të veçantë të Avokatit të Popullit, rezultojnë se:

a. Dhuna në familje është një fenomen mjaft i përhapur në shoqërinë shqiptare dhe si rrjedhojë, është përgjegjësia e shtetit, komunitetit dhe individëve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta ndaluar atë. Për këtë qëllim është kërkuar që autoritetet shtetërore përgjegjëse të ndërmarrin inisiativat e duhura kundër këtij fenomeni, në mënyrë që të respektohen dhe plotësohen të drejtat themelore të grave dhe fëmijëve si pjesë e të drejtave të njeriut. Pavarësisht nga inisiativat dhe aktivitetet e organizatave të ndryshme, veprimet e ndërmarra nga shteti kanë mundësinë të unifikojnë dhe të konsolidojnë këto përpjekje dhe pse jo t'i nxisin dhe promovojnë.

b. Është rritur numri i individëve që i drejtohen gjykatës për arsye të dhunës si dhe numri i urdhërmbrojtjeve të lëshuara prej tyre. Vihet re që ndër vitet e zbatimit të ligjit, ka pasur një zgjerim të numrit të gjykatave që kanë lëshuar urdhra mbrojtjeje për viktimat e dhunës në familje, duke mos mbetur vetëm në gjykatat e qyteteve të mëdha, por edhe në ato të rretheve më të vogla.

c. Procesi i dëmshpërblimit të gruas që ka pësuar torturë ose dhunë seksuale, ose forma të tjera të keqtrajtimit, në praktikë është i vakët. Padia civile në procesin penal përdoret shumë rrallë. Faktori kryesor është mendësia sipas së cilës, “nderi nuk mund të blihet me para”, por ka, gjithashtu, edhe një sërë faktorësh të tjerë.

d. Përveç punës që bëjnë disa organizata jofitimprurëse për ndërgjegjësimin dhe gjetjen e rrugëve konkrete për përmirësimin e situatës, duhet që të gjenden mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Organet që merren me dhënien e drejtësisë duhet të shohin me prioritet rastet kur pjesë e keqtrajtimit dhe e dhunës së ushtruar janë gratë dhe vajzat. Ato shpesh detyrohen të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër.

e. Fuqizimi ekonomik i grave përbën një ndër kushtet themelore për arritjen e barazisë gjinore, reduktimin e dhunës me bazë gjinore.

f. Integrimi gjinor duhet të jetë pjesë e gjithë politikave sociale, ekonomike dhe politike në Shqipëri për të pasur arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm nëpërmjet shfrytëzimit të potencialit të plotë njerëzor të vendit, sikurse dhe garantimit të gëzimit të këtyre arritjeve nga të gjitha grupet shoqërore.

g. Duhet të forcohen mekanizmat për barazinë gjinore në nivel qendror dhe vendor, veçanërisht shpejtimi i procesit për emërimin e nëpunësve gjinorë në strukturat e Ministrive dhe të nëpunësve vendorë për çështjet gjinore në bashkitë e vendit.

h. I duhet dhënë prioritet politikave për pjesëmarrjen e grave dhe vajzave nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në programe aktive punësimi dhe formimi profesional.

i. Duhet të ngrihen mekanizmat e referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, në të gjitha bashkitë e vendit, brenda këij viti në mënyrë që të fillojë efektivisht funksionimi i këtij mekanizmi.

j. Duhet të ngrihen nga organet e qeverisjes vendore, strehëza të trajtimit të viktimave të dhunës, të cilat gjenden në territorin ku shtrin juridiksionin e saj njësi e qeverisjes vendore, në perputhje me nevojat e komunitetit.

k. Duhet të vlerësohet mundësia e bashkëpunimi ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore me organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës. Zbatimi me efektivitet I këtij bashkëpunimi kërkon të vlerësohet mundësia e financimit të organizatave të shoqërisë civile nga fondet e njësive të qeverisjes vendore, apo nga fondet buxhetore.

Në përfundim lidhur me këtë cëshjtje, theksojme se Institucioni i Avokatit të Popullit ka vendosur një bashkëpunim të formalizuar me organizatat jofitimprurëse të cilat kanë në fushën e veprimtarisë së tyre çështjet e viktimave të dhunës.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, në periudhën në vijim do të mundësohen aktivitete të përbashkëta për :

a. vlerësime, studime dhe analiza për gjendjen e të drejtave të viktimave të dhunës,

b. nxjerrjen e rekomandimeve për zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi, që trajtojnë viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare,

c. ndërgjegjësimin dhe fushata sensibilizuese për viktimat e dhunës në familje,

d. vjeljen e problematikave kryesore me të cilat ndeshet kjo kategori, për trajtimin dhe integrimin e tyre në shoqëri.

2. Përsa i përket të drejtave të Komunitetit LGBT dhe masës 11.2.3 “Zhvillim i një programi konkret pune, aktiviteteve sensibilizuese për personat LGBT”.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka paraqitur në mënyrë zyrtare komentet lidhur me këtë program konkret pune.

Përveç mendimeve për formalizimin e grupit të punës që duhet të punonte për hartimin këtij Plani Veprimi, në të cilin duhet të ishin të ftuar edhe përfaqësues të institucioneve të pavarura kushtetuese apo të institucioneve të tjera të pavarura, si dhe përgjegjësitë që duhet të merrte përsipër cdo përfaqësues i institucioneve, kemi sugjeruar edhe:

-shtimin në Planin e Veprimit të masave të tjera, pasi masat e parashikuara, ishin të pamjaftueshme për realizimin e një sërë objektivash dhe politikash.

-shtimin edhe të dy kollonave të tjera, ajo e treguesve apo indikatorëve që përcaktojnë realizimin e masave, si dhe kollona për burimin e financimit të kostos së masës konkrete. Vlerësojmë se përfshirja e këyre elementëve janë tepër të rëndësishme, për të garantuar zbatimin e tyre nga autoritetet shtetërore përgjegjëse.

-përfshirjen në Planin e Veprimit, si autoritete që mund të kontribuojnë për zbatimin e masave të caktuara, edhe të institucioneve të pavarura, si Avokati i Popullit apo Komisionerja për Mosdiskriminimin.

Lidhur me të drejtat e komunitetit LGBT, institucioni i Avokatit të Popullit është duke përfunduar një raport të posaçëm lidhur me ndërhyrjet dhe rekomandimet që janë dhënë gjatë këtyre muajve të fundit, për përmirësime ligjore apo për marrje masash nga autoritete shtetërore përgjegjëse.

Në këtë raport janë trajtuar tre çështje të rëndësishme si :

a. Analiza dhe vlerësimi i legjislacionit shqiptar, krahasimi i përcaktimeve të tij me parashikimet që kanë aktet ndërkombëtare dhe direktivat e EU, për mosdiskriminimin e komunitetit LGBT në ushtrimin e të drejtës për punësim dhe formim profesional, si dhe rekomandimi i nxjerrë lidhur me këtë çështje. Lidhur me këtë çështje, i shtë derguar një rekomandim legjislativ Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shënaseve të Barabarta, për ndryshimin e nenit 9 të Kodit të Punës. Ministri në përgjigje të këtij rekomandimi ka pranuar përfshirjen e propozimit në ndryshimet që do t'i bëhen Kodit të Punës.

b. Analiza dhe vlerësimi i legjislacionit penal shqiptar, krahasimi i përcaktimeve të tij me parashikimet që kanë aktet ndërkombëtare apo edhe eksperiencia e vendeve të tjera, në drejtim të përcaktimeve për krimet e urrejtjes ndaj komunitetit LGBT,

c. Rekomandimi drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për:

-Përfshirjen në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBT, me qëllim arsimimin në një mjedis të sigurt pa dhunë, fyerje, përjashtim social apo trajtim çnjerëzor, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.

-Trajnimin e stafit akademik për moslejimin e cdo forme diskriminimi duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore për shkak të përkatësisë së tyre seksuale.

Gjithashtu lidhur me promovimin e të drejtave të Komunitetit LGBT në Shqipëri, Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur një rol shumë aktiv si bashkëorganizator i Festivalit të Diveristetit në Tiranë, në 17 maj, por jo vetëm, ai ka qenë pjesmarrës edhe në aktivitete të tjera të organizuara gjatë atyre ditëve.

3.Lidhur me të drejtat e fëmijëve dhe masën “Organizimi i mbledhjes së parë të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve”.

Megjithëse aktet nënligjore për krijimin e tij, si dhe për rregulloren e funksionimit të tij, kanë më tepër se një vit që janë miratuar, konstatojmë se ky organ konsultativ i politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ende nuk është mbledhur.

Sipas parashikimeve të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të femijëve në këtë Këshill, konsultohen politikat, planet e veprimit, ndryshimet në legjislacionin për të drejtat e femijëve etj.

Pavarësisht kësaj, theksojmë se Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve, anëtar i të cilit është edhe Avokati i Popullit, nuk është mbledhur asnjëherë, edhe pse gjatë kësaj periudhe janë nxjerrë akte të rëndësishme si, Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e politikave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, apo edhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit kuadër për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve etj. Pra të gjitha këto dokumente dhe akte nënligjore nuk janë konsultuar në Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve.

Përveç sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se është tepër e rëndësishme mbledhja e këtij Këshilli, me qëllim që të

monitorohet veprimtaria e autoriteteve shtetërore përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe legjislacionit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu mendojmë që Këshilli duhet të miratojë një kalendar pune të tij, për çështjet që do të diskutojë dhe vlerësoj gjatë këtij viti.

Një tjetër çështje që paraqet rëndësi të madhe lidhur me garantimin e të drejtave të fëmijëve është edhe ngritja e mekanizmave të referimit të fëmijëve në rrezik në nivel vendor. Vendimi i Këshillit të Ministrave për ngritjen këtij mekanizmi, tashmë ka hyrë në fuqi, por duhet të ndërmerren veprime konkrete për shtrirjen e mekanizmit në të gjithë territorin e vendit.

Gjithashtu Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, duhet të fillojë të funksionjë në përputhje me kompetencat që i ka njohur ligji për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe akti nënligjor në zbatim të tij, veçanërisht në vlerësimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.

4.Lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe masën 11.8.2 “Vendosja e një kalendari për miratimin e ligjit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”

Gjatë këtij viti, Institucioni i Avokatit të Popullit ka paraqitur në Kuvend, në Komisionin e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, komente dhe mendime për ndryshimet e ligjeve “Për statusin e të verbërit”, si dhe “Për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”. Në vlerësimin tonë, ndryshimet në keto ligje kanë çenuar parimin e sigurisë juridike, duke ndikuar në këtë mënyrë në cënimin e të drejtave të garantuara më parë me dispozita ligjore.

Gjithashtu në datën 25 qershor 2012, Institucioni i Avokatit të Popullit organizoi në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Personave me Aftësi të Kufizuara, Konferencën kombëtare me temë “Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, pjesë integrale e të drejtave të njeriut”.

Në Konferencën Kombëtare u ftuan të merrnin pjesë anëtarë të qeverisë, përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare, si dhe organizata për të drejtat e njeriut, dhe veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara.

Nga diskutimet dhe debatet e zhvilluara në konferencë u konstatua se:
1.Gjendja e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuar vazhdon të mbetet shqetësuese. Legjislacioni shqiptar ka ende vend për të siguruar mundësi dhe shanse të barabarta për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Kushtetuta e vendit nuk përcakton në nenin 18

të saj si shkak diskriminimi aftësinë e kufizuar si dhe nuk e ndalon shprehimisht atë në asnjë nga dispozitat e saj. Gjithashtu Kushtetuta nuk i njeh personave me aftësi të kufizuar, mbrojtje të veçantë nga shteti ashtu siç jua njeh në paragrafin 1 të nenit 54 kategorive të tjera si: fëmijëve, fëmijëve të lindur jashtë martese, të rinjve, grave shtatzëna dhe nënave të reja.

2. Aksesit në drejtësi i personave me aftësi të kufizuara, është më i kufizuar nga parashikimet që ka për këtë çështje në Konventën OKB “Për të drejtat e PAK”. Për këtë qëllim nevojiten përmirësime të rëndësishme të legjislacionit procedural. Në praktikë respektimi i kapaciteteve ligjore vazhdon të jetë ende mjaft problematik. Personave me aftësi të kufizuar iu mohohen mjaft herë të drejtat themelore deri edhe në heqjen e zotësisë për të vepruar apo mohimi i të drejtës prindërore.

3. Personat me aftësi të kufizuara, përballohen dita ditës me përjashtimin shoqëror dhe me shanse të pabarabarta në jetën e përditëshme. Vihen re përpjekje dhe praktika pozitive në fushën e edukimit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka marrë seriozisht në dorë krijimin e hapësirave dhe shanseve për arsimin integruar për personat me aftësi të kufizuar. Kjo politikë është reflektuar dhe me ligjin e ri për arsimin parauniversitar. Mbeten shqetësuese shanset për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, mungon ndërhyrja e shtetit nëpërmjet qendrave publike të formimit profesional për përshtatjen e tyre në tregun e punës, apo mbështetja me fonde nga buxheti i shtetit i programeve për përshtatjen e vendeve të punës për personat me aftësi të kufizuara. Legjislacioni për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara nuk është i plotë, por edhe ato dispozita që janë në fuqi nuk zbatohen në praktikë. Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka filluar përpjekjet për hartimin e ligjit për ngritjen e ndërmarrjeve apo bizneseve sociale me qëllim punësimin e njerëzve në nevojë, por vizioni i këtij ligji është tepër i gjerë dhe duhet që të jetë më konkret për personat me aftësi të kufizuara. Përjashtimi shoqëror është i dukshëm edhe në pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në veprimtaritë artistike e kulturore dhe sportive. Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve ka financuar aktivitete të ndryshme nëpërmjet projekteve të vogla, por ende nuk ka një zë buxhetor të dedikuar për këto grupe, të rregulluar me dispozita ligjore.

4. Shërbimet e posaçme për personat me aftësi të kufizuara, vazhdojnë të mbeten në nivel tejet të ulët. Decentralizimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror pranë pushtetit vendor është konsideruar një hap pozitiv, por në praktikë është akoma larg të qenit konkret. Strategjia për shërbime të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, mbetet ende e

pazbatueshme kryesisht për shkak të mungesës së fondeve dhe rregullimeve të përshtatshme ligjore. Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Social Shtetëror, kanë bërë përpjekje për të përcaktuar standartet e shërbimeve rezidenciale që ofrohen nga institucionet publike dhe subjektet private, por shqetësues mbetet zbatimi i tyre. Megjithatë trasparenca e përdorimit të fondeve nuk është e kënaqshme si për institucionet publike ashtu dhe për përfituesit.

Per shkaqet e permendura me lart, të mohimit të kapaciteteve ligjore, dhe të mentalitetit përjashtues të mjaft individëve në administratën publike, është cënuar e drejta e përfaqesimit të personave me aftësi të kufizuara për trajtimin e problemeve që i shqetësojnë vetë ata. Ende nuk pranohet qartazi dhe pa ekuivok ekzistenca e lëvizjes së aftësisë së kufizuar, organizimi i saj në shoqata lokale e kombëtare e drejtuar dhe udhëhequr nga vetë personat me aftësi të kufizuara. Institucionet publike në shume raste e shmangin këtë realitet duke mos ju dhënë mundësinë atyre për tu njohur apo konsultuar me drafte apo iniciativa të ndryshme ligjore dhe nënligjore, strategji sektoriale apo orientime të rëndësishme në politika sociale.

Gjithashtu u konstatuar se përfshirja shoqërore e personave me aftësi të kufizuara nuk po mbështetet sa duhet nëpërmjet programeve efektive sociale, të cilat po reduktohen gjithnjë e më tepër kohët e fundit.

Konferenca kombëtare në përfundim të saj, pas këtij diskutimi me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të përfshirë në të, pra të gjitha kategorive të personave me aftësi të kufizuara, përfaqësuesve të Institucionit të Avokatit të Popullit, qeverisë, përfaqësuesve të disa organizatave të të drejtave të njeriut rekomandoi:

1.T'i propozohet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, ndërmarrja e një nisme që të përfshijë:

a. në nenin 18 të Kushtetutës së RSH, ndalimin e dsikriminimit edhe për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

b.në nenin 54 të Kushtetutës, për dhënien e një mbrojtje të veçantë nga shteti edhe kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.

2.T'i propozohet Qeverisë shqiptare që të ndërmarrë nismën për ratifikimin me prioritet të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar”, dhe vetëm pas ratifikimit të saj të procedohet me reforma të tjera ligjore të legjislacionit shqiptar në fuqi.

3.T'i propozohet Qeverisë shqiptare ndërmarrja e nismës për ndryshimin e nenit 3, pika 7 të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe konkretisht përshtatjen e shprehjes “*barre e tepruar*” me një shprehje apo përcaktim në përputhje me parashikimet e Konventës së OKB “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, apo instrumentat ligjore të BE-së në këtë fushë, që mund të jetë “akomodim i arsyeshëm”, “barre joproporcionale dhe e padrejtë”.

Përsa i përket miratimit të ligjit integral për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Institucioni i Avokatit të Popullit është njohur lidhur me përmbajtjen tij gjatë muajit qershor 2012, në një takim të organizuar lidhur me ligjin.

Projektligji që propozohet parashikon në brendinë e tij dispozita të cilat janë trajtuar në Konventën e OKB për PAK. E rëndësishme është që të theksojmë se Shqipëria nuk ka nevojë për një ligj që përserit dispozitat e Konventës së OKB. Në një ligj kuader apo integral, por ajo duhet të parashikojë në legjislacionin e brendshëm të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo Konventë. Sipas nenit 122 të Kushtetutës, Konventa në momentin e ratifikimit të saj nga Shqipëria, behet pjesë e sistemit të brendshëm juridik, pra dispozitat e saj nuk është e nevojshme të transpozohen në një ligj të brendshëm.

Nga dispozitat e fundit të projektligjit, të cilat përcaktojnë shfuqizimin gradual të statuseve të vecanta të PAK, nënkuptohet që ligji është ideuar për të qenë një ligj midis formatit të një ligji kuader dhe një ligji integral për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, por pa plotësuar asnjë kriter që duhet të ketë një ligj i një formati të tillë. Një ligj i tillë duhet të parashikojë përcaktime konkrete lidhur me të drejtat, mbrojtjen, shërbimet, kriteret e përfitimit, nivelin e tyre etj, të pakten në referencë të rregullimeve ligjore që janë në fuqi në momentin e miratimit të tij (p.sh në statutet e vecanta). Në projektligj nuk parashikohet asnjë rregull apo masë konkrete, për sigurimin e jetesës së pavarur, apo për të mundësuar pjesëmarrjen e plotë dhe të efektshme në të gjitha sferat e shoqërisë, të personave me aftësi të kufizuara. Projektligji bën thjesht vetëm një listim të të drejtave dhe shërbimeve, duke deleguar në akte nënligjore sigurimin e tyre, apo rregullat në bazë të të cilave ato do të ofohen, duke e lënë në vendimarrjen e Këshillit të Ministrave, apo ministrave garantimin e tyre (nenet 6,7, 8, 13, 21 dhe 24 të projektligjit). Formatimi në

menyre te tille i projektligjit, cenon parimin e sigurise juridike ne kuptim te nenit 4 te Kushtetutes, sipas te cilit ligji duhet te percaktoje te drejtat, perfitimet dhe nivelin e mases se tyre.

Lidhur me institucionin që do të monitorojë zbatimin e ligjit dhe të të drejtave të PAK, theksojmë se është kërkuar nëpërmjet përfaqësuesi të institucionit të Avokatit të Popullit në grupin e punës, që institucioni ynë të monitorojë zbatimin dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, nga veprimet ose mosveprimet e parregullta dhe të paligjshme të organeve të administratës publike, si dhe personave të tretë të lidhur me të. Nëse personi me aftësi të kufizuara pretendon se i është mohuar një e drejtë (e drejta për strehim, e drejta e organizimit, e drejta për informim, e drejta për punësim, e drejta për sigurime shoqërore etj), nga organet e administratës publike, për çfarëdo lloj shkak, përjashtuar diskriminimit, ai në bazë të Kushtetutës, por edhe ligjit organik të Avokatit të Popullit mund t'i drejtohet këtij të fundit për të filluar një hetim administrativ lidhur me pretendimet e tij. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit duhet të jetë organi që do të monitorojë zbatimin e të drejtave të PAK nga organet e administratës publike.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë duke u përgatitur edhe disa rekomandime lidhur me zbatimin e legjislacionit që trajton çështje të posaçme të të drejtave të PAK (punësimi i tyre, nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të ligjit për nxitjen e punësimit, montorimin e zbatimit të dispozitave ligjore nga Inspektorati Shtetëror i Punës etj). Së fundmi i është dërguar Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta një rekomandim për përsheptimin e punës për hartimin e projektligjit për ratifikimin e Konventes së OKB “Për të drejtat personave me aftësi të kufizuara”.

5. Lidhur me të drejtat e minoritetit rom, dhe masat e parashikuara në pikën 11.9.6 të Plani të Veprimit për rekonmandimin 11, theksojmë se:

Duke marrë shkas nga situata e krijuar si rezultat i largimit nga vendstrehimi i përkohshëm i disa familjeve rome, të vendosura në Babrru, Tiranë, Institucioni i Avokatit të Popullit, filloi shqyrtimin me iniciativë të trajtimit të këtij rasti me datë 01.02.2012.

Duke qenë se kushtet e vështira klimaterike të atyre ditëve të ftohta, temperaturat e ulta që priteshin të vazhdonin në ditët në vijim, bënë emergjente marrjen e masave në ndihmë të kategorive të tjera të

popullsisë, si personat endacakë apo të pastrehë, me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre, veçanërisht të fëmijëve.

Në këto kushte i është rekomanduar **Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile, z. Alfred Olli si dhe Kryetarëve të Bashkive dhe Kryetarëve të Keshillave Bashkiake** në të gjithë vendin:

“Marrja e të gjitha masave të mundshme organizative për përgatitjen e vend-strehimeve apo vend-qendrimeve provizore për grupe të tilla në nevojë emergjente, si pjestarë të komunitetit rom, personave endacakë apo të pastrehë dhe këdo tjetër që kërkon ndihmë nga organet e pushtetit vendor, me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre, veçanërisht të fëmijëve”.

Vijojmë ta konsiderojmë se kjo çështje duhet të trajtohet me përparësi nga ana e autoriteteve vendore, për të marrë në vazhdimësi masat e duhura, me qëllim që të paraprihen situata të vështira jetësore, të cilat mund të ndodhin në stinën e dimrit gjatë vitit kalendarik në vazhdim, apo edhe në vitet e ardhshme. Në këtë kontekst vlerësojmë se autoritetet vendore duhet të hartojnë plane veprimi dhe ndërhyrje afatmesme, për parandalimin e situatave të tilla në të ardhmen. Këto plane masash duhet të parashikojnë veprime dhe ndërhyrje konkrete, institucionet apo autoritete përgjegjëse për realizimin e tyre, afatet për plotësimin e tyre, burimet e nevojshme financiare etj.

Problematikat e konstatuara për 8 (tetë) familjet e komunitetit Rom, të cilët janë transferuar ne ambjentet e ish Repartit Ushtarak në Sharrë, Kombinat.

Nga data 1 shkurt e vitit 2012, për 12 ditë me radhë, 8 familjet e komunitetit rom me 59 anëtare mes të cilëve 30 fëmijë nga moshja 0-7 vjeç u strehuan në kushte emergjence në ambjentet e institucionit të Avokatit të Popullit. Këto familje ishin paralajmëruar për dëbim nga zona ku kishin ngritur çadrat e tyre brenda datës 01.02.2012. Pas konstatimit të situatës së rëndë, Avokati i Popullit premtoi strehimin e drejtpërdrejtë të tyre në ambientet e institucionit, nëse shteti nuk gjente zgjidhje në përshtatje me kushtet e tyre të emergjencës.

Menjëherë pas sistemimit të familjeve romë në institucionin e Avokatit të Popullit, mbërritën dhe ndihmat nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat të kooordinuara me njëra-tjetrën kanë ndihmuar me ushqim, veshmbathje dhe ilaçe këto familje gjatë këtyre ditëve. Organizatat që ndihmuan në kalimin e kësaj situatë emergjence ishin: Eorld Vision, Terre des Hommes, SFI, CRCA, Alo 116, TLAS, Kryqi i Kuq Shqiptar etj. Po

keshtu dhe nga Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shëndetit Publik u kryen rregullisht vizita mjekësore për fëmijët. Gjatë kohës së qëndrimit të 8 familjeve rome në ambientin e institucionit, Avokati i Popullit bëri përpjekje të vazhdueshme për të gjetur një zgjidhje, kjo edhe në kuadër të zbatimit të masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Minoritetin Rom dhe për Planin e Veprimit për Dekadën e Romëve.

Krahas 8 familjeve që u strehuan në kushte emergjence në datën 1 shkurt 2012 brenda zyrave të Avokatit të Popullit, një numër familjesh rome erdhi në datën 3 shkurt 2012 në mjediset e këtij institucioni. Këto familje i shprehën Avokatit të Popullit shqetësimin se kanë të njëjtat probleme me 8 familjet e strehuara në ambientet e tij. Avokati i Popullit vuri në dispozicion të tyre të gjithë personelin e zyrës duke kryer këshillimin, marrjen e ankesave dhe identifikimin e kategorive dhe problemeve ligjore të cilave ata ju përkisnin.

Familjet rome të cilat u strehuan në zyrat e Avokatit të Popullit në kushte emergjence që nga datën 1 shkurt 2012 u larguan mesditën e datës 12 shkurt dhe u strehuan në ambientet e “Romani Baxt Albania”. Këto familje të pastreha qëndruan në mjediset e vëna në dispozicion nga kjo shoqatë deri në përfundimin e punimeve në ambientin e paracaktuar për ta nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, ambiente të cilat sipas kësaj ministrie, do të ishin gati pas një muaji. Gjatë kësaj periudhe organizata “Romani Baxt Albania” u mbështet me fonde nga Fondacioni Vodafone Albania. Pas një qëndrimi rreth 3 mujor në qendrën “Romani Baxt Albania”, 8 familjet rome, nën kujdesin e Ministrisë së Punës dhe të shoqëruar nga forca policie në datën 8 maj 2012, janë shoqëruar në ambientet e një ish- reparti ushtarak në zonën e Sharrës.

Gjatë kësaj periudhe Avokati i Popullit, lidhur me trajtimin e minoritetit rom, i ka nisur këto rekomandime institucioneve përgjegjëse:

1. Ministrit të Brendshëm, Z.Bujar Nishani për marrjen e masave për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom në regjistrat e gjendjes civile dhe lehtësimin e procedurave të transferimit të të dhënave të gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin e ri.

Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministria e Brendshme informon se komuniteti Rom, ashtu si çdo shtetas shqiptar, gëzon të njëjtat të drejta si në çdo fushë dhe në atë të shërbimit të gjendjes civile.

Pavaresisht lehtësirave të ofruara për të gjithë shtetasit në Republikën e Shqipërisë, Avokati i Popullit, këmbëngul se në mungesë të një informacioni apo për shkak dhe të indiferentizmit të disa pjesëtarëve të komunitetit Rom, mbetet një çështje ende e pazgjidhur regjistrimi i këtyre

familjeve në vendbanimin e ri, pasojë e së cilës, siç e theksuam me lart është mospasja akses në përfitimet ligjore. Gjithashtu vlerësojmë se nuk është e mundur, bazuar ne kriteret e vendosura ne aktet nenligjore, qe nje familje rome te regjistrohet ne qytet, pasi nuk mund te permbushen prej tyre kriteret e percaktuara ne aktet nenligjore (si kriteri qe familja te kete nje banese ne pronesi apo me qira). Per familjet rome eshte e pamundur qe te kenë një banesë në pronësi, apo me qira. Mosplotesimi i ketij kriteri sjell për pasojë mosregjistrimin apo transferimin e tyre nga nje njesi e qeverisjes vendore ne nje tjetër. Mbi sa më sipër, Institucioni i Avokatit te Popullit vazhdon të mbetet i mendimit që duhet të ketë lehtësim të kriterëve dhe procedurave për regjistrimin dhe trasferimin e familjeve rome.

2. Ministrit të Arsimit, Z.Myqerem Tafaj për marrjen e masave për ngritjen e klasave përgatitore për arsimin parashkollor, për mësimin e gjuhës shqipe, me qëllim pjesëmarrjen e fëmijëve romë në të gjitha nivelet e arsimit dhe bashkërendimin e punës me Drejtoritë Rajonale Arsimore, për të ndërgjegjësuar pjesëtarët e komunitetit rom për moslargimin e fëmijëve të tyre nga ndjekja e shkollës. Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministria e Arsimit dhe Shkencës informoi se ka një plan të detajuar veprimi për përfshirjen me prioritet të fëmijëve romë dhe egjiptianë në kopshte dhe shkolla. Është rishikuar dhe buxhetuar “Plani i veprimit për arsimimin e fëmijëve romë” dhe për realizimin e tij, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore raportojnë periodikisht në MASH. Gjatë periudhave në vijim (dhe në fillim të vitit të ri shkollor), institucioni i Avokatit të Popullit do të monitorojë zbatimin e këtij plani veprimi për arsimimin e fëmijëve romë.

3. Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, z.Spiro Ksera për marrjen e masave për përfshirjen në vazhdimësi, me prioritet, të pjesëtarëve të minoritetit Rom në programet e formimit profesional dhe punësimin në vazhdimësi, me prioritet, të personave në moshë pune të minoritetit Rom, me qëllim integrimin e tyre në jetën shoqërore dhe përmirësimin e kushteve social-ekonomike, që ky minoritet të mos ndihet i diskriminuar.

Në përgjigje të këtij rekomandimi Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta informon se ka ndërmarrë nisma konkrete për hartimin e politikave nxitëse dhe lehësuese për komunitetin Rom, me synim nxitjen e punësimit të tyre si dhe kualifikimin, trainimin dhe integrimin e tyre në tregun e punës.

Sipas të dhenave statistikore të tregut të punës në vite për punëkërkesit e papunë nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, të cilat na janë derguar, nga MPÇSSHB, konstatojmë se në vitin 2011 numri i punëkërkesve të papunë romë dhe egjiptianë të regjistruar në Zyrrat Rajonale të Punësimit ka qenë me i lartë se në vitin 2010. Konkretisht në vitin 2011 ka qenë 6970, ndërsa në vitin 2010 ka qenë 7666. Janë trajnuar pranë qendrave publike falas në vitin 2011, 217 persona, nga 62 të trajnuar në vitin 2010.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se pavaresisht kërkesave të rritje nga komuniteti rom, për regjistrim si punëkërkes të papunë pranë Zyrrave Përkatese të Punësimit, Avokati i Popullit konstaton se numri i punëkërkesve të papunë Romë, të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit në vitin 2011 është ulur në krahasim me 2010. Konkretisht në vitin 2011 numri ka qenë 6 persona, krahasuar me vitin 2010, ku numri ka qenë 28 persona.

Në vijim të impenjimit institucional sa i përket zgjidhjes përfundimtare të problemit të strehimit të 8 familjeve të komunitetit rom, të cilët në muajin Shkurt u strehuan pranë Institucionit të Avokatit të Popullit dhe më pas në Qendrën Romani Baxt Albania, ekspertë të Avokatit të Popullit kryen një inspektim pranë ambjentëve të ish-Repartit Ushtarak Sharrë, Kombinat, Tiranë, ku këto familje priteshin të strehoheshin për një periudhë relativisht të gjatë kohore.

Pas inspektimit, dhe konstatimit të kushteve dhe standardeve të kësaj qendre, iu dergua Rekomandim **Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta Z.Spiro Ksera**, për marrjen e masave lidhur me:

- a.Hidroizolimin e godinave të destinuara për ambjente banimi;*
- b.Vendosjen e dyerve dhe dritareve në të tre godinat;*
- c.Mobilimin e ambjentëve me orenditë e nevojshme për të krijuar kushte normale për jetesë;*
- d.Funksionimin e sistemit elektrik dhe hidraulik;*
- e.Vendosjen e dusheve dhe të pajisjeve hidro-sanitare në tualetet e përbashkëta;*
- f.Sistemimi i ambjentëve të përbashkëta përreth godinave.*

Në vijim të ndjekjes dhe kontakteve nga afër që kemi patur me familjet e strehuara, me datë 18.05.2012, kemi inspektuar ambjentet e ish repartit ushtarak dhe kushteve të jetesës së të gjitha familjeve romë që janë akomoduar aty.

Problematikat e prezantuara nga kryefamiljaret e tyre kanë qënë të shumta. Instalimet në godinat për furnizimin me energji elektrike ekzistojnë, por në drejtim të ofrimit të këtij shërbimi, nevojitet një transformator i cili do të bëjë të mundur furnizimin me energji në ambjentet ku strehohen familjet. Për këtë problem, kryefamiljaret pretenduan se përfaqësues të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta u kishin premtuar zgjidhje në një takim të bërë ndërmjet tyre, duke ofruar asistencën e një transformatori në këto kushte, por dhe ndihmesën për të gjitha problemet e tjera.

Faktikisht, situata prezantohej e tillë se asnjë masë nuk ishte marrë dhe në fakt në ambjentet e inspektuara brenda rrethimit të repartit ushtarak Sharrë (*reparti i cili ndodhet në një kodër të Lagjes Sharrë, Kombinat, Tiranë*), rezultonte se gjëndja e rrjetit elektrik dhe hidraulik në sipërfaqen e godinave në fjalë ishte tejet jo funksionale, për shkak se ato nuk furnizoheshin me energji elektrike (por dhe ujë). Gjithashtu, në ambientet e banimit mungonin tërësisht ndriçuesit artificialë, si dhe rrjeti elektrik ishte i dëmtuar.

Avokati i Popullit, megjithese nuk e ka në funksionet e tij detyrimin për të garantuar shërbimin dhe kushtet e nevojshme ndaj minoritetit rom, vijoi përpjekjet maksimale në drejtim të plotësimit të kushteve të përshtatshme të jetesës për këta persona, duke u përpjekur për të siguruar të paktën furnizimin me ujë të pijshëm dhe kanalizimin e ujërave të ndotura në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Ujësjetës Kanalizimeve sha. Tiranë.

Problematike mbetej gjëndja e furnizimit me energji elektrike, me qëllim funksionimin e ambjenteve për banim të ketyre familjeve rome.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është një nga strukturat përgjegjëse për marrjen e masave prioritare për garantimin e standardeve në këtë qendër.

Në këto kushte, i jemi drejtuar **Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta** me rekomandimin :

“Për marrjen e masave në drejtim të lidhjes së rrjetit elektrik kryesor me rrjetin e brendshëm në ambjentet e Repartit Ushtarak Sharrë, Kombinat, Tirane, ku janë strehuar disa familje të komunitetit Rom.”

Lidhur me kete rekomandim nuk kemi marrë asnjë pergjigje lidhur me qëndrimin dhe veprimet e ndërmara nga MPCSSHB për zbatimin e tij.

Gjithashtu është derguar një rekomandim për **Drejtorinë e Ndërmarrjes Ujësjetës Kanalizime** sh.a, ku kërkuam:

“Marrjen e masave të nevojshme për furnizimin pa ndërprerje me ujë të pijshëm, të ambjenteve të Repartit Ushtarak Sharrë, Kombinat, Tiranë, ku janë strehuar disa familje të komunitetit rom.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, u vumë në dijeni se Shoqëria e Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a, nga verifikimi në vend i situatës në ambjentet e ish Repartit Ushtarak në Sharrë, vlerësoi se për momentin ishte e pamundur furnizimi i këtyre familjeve nga rrjeti i ujësjetllësit, pasi në atë zonë nuk kishte rrjet. Gjithsej nga UKT u premtua marrja e masave për sistemimin e një depozite 5000 litra brenda ambjentit ku banojnë keto familje, furnizimi i së cilës përkohësisht do të bëhej me autobot nga shoqëria, derisa ky problem të merrte zgjidhje definitive. Ne vijim te investimeve të planifikuara nga UKT, është dhe sistemimi i furnizimit me ujë i kesaj zone, gje e cila do të bente të mundur edhe furnizimin e këtyre familjeve.

Gjithashtu gjatë inspektimit në qendrën ku ishin të sistemuar familjet rome, u konstatua se fëmijët e familjeve rome nuk frekuentonin shkollën. Nga intervistat e marra rezultoi se ishin 35 fëmijë, nga të cilët 20 të grupmoshave nga 1 deri në 5 vjeç dhe pjesa tjetër (15 fëmijë) deri në moshën 14 vjeçare. Asnjë prej këtyre fëmijëve nuk ishin të regjistruar në shkolla, për të ndjekur arsimin 9-vjeçar.

Lëvizja e shpeshtë e pjesëtarëve të komunitetit rom, nga një vendbanim në tjetrin, ka bërë që ata të mos përfitojnë nga sistemi i mbrojtjes sociale shtetërore, e për më tepër fëmijët e këtij komuniteti, jo vetëm që kanë braktisur bankat e shkollave, por dhe shfrytëzohen në rrugë për të lypur e për punë të rëndomta. Mungesa e informacionit apo dhe neglizhenca e indiferentizmi i tyre, ka bërë që këta shtetas të mos figurojnë të regjistruar në gjendjen civile pranë vendbanimit të tyre. Shumë familje rome janë vendosur në Tiranë prej vitesh dhe mosregjistrimi i tyre ka kufizuar aksesin në përfitimet ligjore dhe në këtë rast të regjistrimit të fëmijëve nëpër shkolla për të ndjekur arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar si dhe atë parashkollor.

Udhëzimi nr.6 datë 29.03.2006 i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për regjistrimin në shkollë të nxënësve rom që nuk janë të regjistruar në gjendjen civile” ka përcaktuar se fëmijët romë mund të regjistrohen në shkollë edhe pa çertifikata të lindjes.

Sa më lart, bazuar në parimin kushtetues se kushdo ka të drejten për arsimim, e sanksionuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë, i jemi drejtuar Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, me rekomandimin:

“Për marrjen e masave për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të komunitetit Rom, të vendosur pranë ish-repartit Ushtarak, Sharrë, Tiranë, në shkollat 9-vjeçare pranë vendbanimit aktual të tyre.”

Në institucionin e Avokatit të Popullit nuk ka mbërritur asnjë përgjigje lidhur me qëndrimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, ndaj këtij rekomandimi.

Avokati i Popullit ndjen keqardhje që qytetarët rom janë larguar para reeth një muaji e gjysem edhe nga ambientet e ish-repartit ushtarak në Sharrë dhe 6 prej tyre janë sistemuar pranë familjeve dhe të afërmeve të tyre në zonën e quajtur Bregu i Lumit në Tiranë, ndërkohë që dy prej tyre janë strehuar pranë ambjentëve të ish-ambasadës Jugosllave në Tiranë. Sipas familjeve romë të sistemuara në ambientet e ish-repartit ushtarak, largimi i tyre ka ardhur për shkak të dhunës nga banorët e zonës, të cilët pretendonin që reparti ushtarak, ishte pronë e tyre.

Lidhur me këtë ngjarje, Avokati i Popullit i ka nisur një letër Drejtorisë së Policisë së Tiranës për të filluar hetimin mbi shkaqet e dëbimit dhe dhunën që është ushtruar, sipas pretendimit të qytetarëve romë.

Një tjetër çështje e rëndësishme e parashikuar në Planin e Veprimit për zbatimin e 12 rekomandimeve të BE për Shqipërinë është, hartimi i një Plani Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të seminarit të dhjetorit 2011 (të z.Pier Mirel). Jemi vënë në dijeni që është përgatitur një draftplan veprimi nga Ministria e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, i cili nuk është finalizuar ende. Lidhur me këtë çështje i është dërguar një shkresë Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, z.Ksera, në datën 9 maj 2012. Nëpërmjet kësaj shkrese i paraqitej kërkesa që Projektplanin e Veprimit të përgatitur nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për zbatimin e rekomandimeve të z.Pier Mirel, dhe i shpërndarë për mendime ministrive dhe institucioneve të linjës, t'i dërgohej për mendime edhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ne mendojmë se këndvështrimi dhe opinionin e Avokatit të Popullit mbi këtë Projektplan Veprimi do të ndikojë në respektimin dhe zbatimin e të drejtave të qytetarëve rom në Shqipëri.

Në përfundim, dëshirojmë të sjellim në vëmendjen tuaj, se për të drejtat e minoritetit rom, dhe trajtimin që i ka bërë ankesave të tyre Institucioni i

Avokatit të Popullit gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, jemi duke përfunduar në raport të veçantë.

V. Rekomandimi 12, zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit për trajtimin e të ndaluarve dhe të dënuarve në burgjet, paraburgim dhe komisaritatet e policisë.

Lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve deri në 15 prill 2012, nga Institucioni i Avokatit të Popullit është përgatitur nje raport i veçantë i cili i është përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Delegacionit të BE në Shqipëri etj.

Në vijim të këtij raporti, gjatë periudhës në vazhdim ka patur këro zhvillime:

Në kuadër të zbatimit të Rekomandimit nr. 12 të Opinionit të Komisionit European”, dhe të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me problematikat e konstatuara në Polici, pasqyrohet vlerësimi i mëposhtëm.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit pasi u njoh me Raportin e Veçantë “Për nivelin e zbatimit të Rekomandimit nr. 12 të Opinionit të Komisionit European”, të punuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit, janë zhvilluar disa takime me qëllim bashkëpunimin midis dy institucioneve për realizimin në kohë dhe me cilësi të Rekomandimit nr.12 të K.E.-së: “ *Të merren masa shtesë për të përmirësuar trajtimin e personave të privuar nga liria në komisaritatet e policisë, paraburgime dhe burgje. Të forcohet ndjekja gjyqësore e rasteve të keqtrajtimin dhe të përmirësohet zbatimi i rekomandimeve të Ombudsmanit për këtë fushë*”.

Në datë 27.03.2012 është zhvilluar takimi midis Avokatit të Popullit dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Z. Hysni Burgaj. Pas këtij takimi D.P.P.Sh. ka hartuar Programin e Punës për përmbushjen e Rekomandimit nr. 12 të K.E.-së dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit si dhe ka ngritur grupin e punës për ndjekjen dhe zbatimin e detyrave në përmbushje të këtyre rekomandimeve.

Në programin e punës përcaktohen masa dhe detyra konkrete që duhet të merren për realizimin e rekomandimeve të Komisionit European dhe të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Për disa nga këto detyra janë vendosur edhe afate. Grupi i punës i ngritur nga D.P.P.Sh. për zbatimin e këtij plani udhëhiqet nga Zëvendësdrejtoi i Përgjithshëm I Policisë së Shtetit, për Sigurinë Publik.

Grupi i punës i D.P.P.Sh. ka bashkëpunuar me ekspertët e Avokatit të Popullit lidhur me rekomandimet e bëra nga ana e tij. Deri më sot janë zhvilluar disa (gjashhtë) takime ndërmjet grupit të punës në D.P.P.Sh dhe ekspertëve të Avokatit të Popullit. Fillimisht janë evidentuar problematikat e konstatuara nga Avokati i Popullit të cilat në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë vijon:

1. Kushtet e ambjenteve të shoqërimit dhe të sigurisë, në shumicën e komisariateve të Policisë së Shtetit, janë jashtë standarteve të përcaktuara në ligj;
2. Trajtimi i personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar nuk bëhet gjithmonë sipas ligjit;
3. Ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 “*Për Policinë e Shtetit*”, duhet ndryshuar për arsyet e poshtshënuara:
 - Policisë së Shtetit nuk i është caktuar me ligj trajtimi i personave të ndaluar dhe arrestuar në ambjentet e saj, pavarësisht se ajo e kryen këtë shërbim. Ky funksion i Policisë së Shtetit duhet të normohet me ligj.
 - Rastet kur një person mund të shoqërohet në ambjentet e Policisë së Shtetit duhet të ndryshohen, sepse rastet e parashikuara aktualisht në ligj krijojnë mundësi për abuzim;
 - Në ligj duhet të përcaktohet detyrimi i Policisë së Shtetit për të regjistruar ankesat e të ndaluarve, arrestuarve dhe të shoqëruarve, sepse kjo do të parandalonte shkelje të kryera nga punonjës të policisë.

Në Plan Veprimin e Ministrise së Brendshme lidhur me përmirësimi i kushteve në ambientet e ndalimit dhe komisariate është parashikuar:

1.Përfundimi i punimeve për rikonstruksionin e ambienteve në komisarimatet e policisë për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar sipas standardeve:

- Komisariati i Policisë Kukës në Maj 2011
- Komisariati i Policisë Korçë në Prill 2011
- Komisariati i Policisë Gjirokastrë në Mars 2011

Nga verifikimet e bëra në vend rezulton se, në këto komisariate policie rikonstruksioni i ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë ka përfunduar në afatet e parashikuara por, brenda ambjenteve të shoqërimit në Komisariatin e Policisë Gjirokastrë dhe Kukës ndodhet një dhomë e cila përdoret për përgjim të fshehtë me mjete teknike. Vendosja e kësaj

dhome brenda këtij ambjenti ishte e parashikuar që në projekt. Projekti për ambjentet e shoqërimit hartohet nga strukturat e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe miratohet nga drejtuesit e saj. Ekzistenca e një shërbimi të tillë policor brenda ambjenteve të shoqërimit vjen në kundërshtim me nenin 221 dhe 222 të K.Pr.Penale si dhe nenin 11 pika 6 të ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” në të cilin shprehimisht thuhet se “Shoqërimi, në kuptimin e këtij ligji, nënkupton rastin kur një person ka shkelur një rregull administrativ dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqërimit në zyrat e policisë me ose pa vullnetin e tij”. Ky fakt e kompromenton rëndë ambjentin e shoqërimit si dhe pozitën e personave që qëndrojnë të shoqëruar (deri në 10 orë) brenda tij.

Sa më sipër Avokati i Popullit ka rekomanduar heqjen menjëherë të dhomës së përgjimit të fshehtë nga ambjentet e shoqërimit si dhe mospërsëritjen e këtyre dukurive në të ardhmen. Rekomandimet akoma nuk janë përmbushur.

2.Rikonstruksioni i plotë ambienteve për personat e shoqëruar, ndaluar/arrestuar sipas standardeve në komisariatet e policisë:

- Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë, Qershor 2011

- Komisariati i Policisë Durrës, Qershor 2011

Në këto dy komisariate nuk ka përfunduar rikonstruksioni i ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë brenda afatit Qershor 2011. Në Programin e Punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, afati për realizimin e këtij rikonstruktimi është shtyrë deri në muaji Dhjetor të vitit 2012.

Në inspektimet e Avokatit të Popullit konstatohet se:

Në Komisariatet e Policisë Korçë, Kukës, Gjirokastër, Fier, Lezhë, Kavajë, nr.5 Tiranë dhe Peqin dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë me gjithë mangësit e konstatuara ju për afrohen standarteve të parashikuara në ligj por, në 24 Komisariatet e tjera të Policisë dhomat për të shoqëruar, ndaluar/arrestuarit në fakt si nga përmasat, ndriçimi natyral, higjena ashtu edhe nga konceptimi dhe trajtimi i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar janë dhoma izolimi, sepse janë të ftohta, me dyer hekuri, të mbyllura me dryna, pa ndriçim natyral dhe në disa raste pa ndriçim nga rrjeti.

Si të tilla mund të përmëndim dhomat e sigurisë në Komisariatet e Policisë Nr. 2 dhe 3 Tiranë, në Komisariatet Vlorë, Elbasan, Sarandë, Durrës, Tropojë, Peshkopi, Pogradec.

Në Komisarariat e Policisë Lushnje dhomat e sigurisë, janë jashtë standarteve të përcaktuara në Ligjit, pasi janë të nëndheshme dhe me mundësi të pakët ajrimi. Kjo gjendje dëmton rëndë shëndetin e personave të ndaluar dhe arrestuar pasi koha e qëndrimit të tyre brenda këtij ambjenti varionte nga 3 deri në 15 ditë.

Në komisarariatet e Policisë Përmet, Krujë, Librazhd, Elbasan, Pogradec, Burrel, Berat dhe nr.6 Tiranë dhomat e shoqërimit janë jashtë ndërtesës së komisarariatit, në ndërtesa një katëshe, me soletë të cilat janë të ftohta në dimër dhe të nxehta në verë dhe për pasojë e bëjnë të pa mundur qëndrimin e të shoqëruarve në to.

Në komisarariatet e Policisë Gramsh, Sarandë, Librazhd, Shkodër dhe Pogradec dyert janë prej zgarë hekuri. Rreziku për jetën e të shoqëruarve është më i madh pasi në to krijohen premisa për vetvarje të të shoqëruarve siç edhe ka ndodhur në Komisarariatet e Policisë Lezhë dhe Durrës.

Në komisarariatet e Policisë Laç, Fier, Elbasan, Shijak, nr.2 dhe 4 Tiranë dhomat e shoqërimit janë me derë të blinduar.

Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë edhe pse fluksi i të shoqëruarve është më i madh vazhdon të ketë vetëm një dhomë shoqërimi për femra, një dhomë për të mitur dhe një për madhor.

Në Programin e Punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është lënë detyrë që brenda vitit 2013 të përfundojnë projektet për rikonstruksionin e ambjenteve të dhomave të shoqërimit dhe sigurisë vetëm në Komisarariatet e Policisë Vlorë dhe Dibër.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga D.P.P.Sh. rezulton se, i është lënë detyrë Drejtorive të Policisë së Qarqeve që me fondet e tyre të marrin masa për mirëmbajtjen e ambjenteve të shoqërimit dhe sigurisë që ato kanë në administrimin e tyre si: pajisjen me orënditë e nevojshme për qëndrim dhe fjetje dhe përmirësimin e kushteve higjieno sanitare.

Ambjentet e intervistimit:

Në shumicën e komisariateve të policisë nuk ka ambiente intervistimi dhe të gjitha veprimet kryhen në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore. Në disa zyra të oficerëve të policisë gjyqësore janë gjetur sende të cilat nuk duhet të ndodhen në këto ambiente pasi prezenca e tyre reflekton ushtrim dhune. Sendet e gjetura si shufëra hekuri, shkop bejzbolli, copa druri etj (Komisariati Nr.1 Tiranë, Fier, Gjirokastrë Lezhë etj) Oficerët e policisë gjyqësore pretendonin se këto sende ishin prova materiale dhe ndodheshin në zyrat e tyre pasi nuk kishte dhomë të ruajtjes së provave materiale.

Monitorimi i ambjeteve të shoqërimit të sigurisë dhe hetimit:

Në shumicën e komisariateve të policisë nuk ka sistem monitorimi filmik për të mbajtur tëurvejuar, ambjentet e shoqërimit, të sigurisë dhe të hetimit.

Avokati i Popullit e ka konsideruar procesin e monitorimit filmik të ambjeteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

3.Përmirësimi i përgatitjes profesionale të punonjësve që shërbejnë në ambientet e të ndaluarve në D.P.Qarqeve, Janar-Maj 2011

Sa sipër është bërë trajnimi i 120 punonjësve të policisë që shërbejnë në ambientet e të ndaluarve në D.P.Qarqeve.

4.Trajnim intensiv i personelit policor për të drejtat e personave të shoqëruar dhe të miturve në komisariate, për intervistimin dhe këshillimin që duhet t'u afrohet

Në programin e punës të hartuar nga D.P.P.Sh. janë përfshirë rekomandimet e Avokatit të Popullit të cilat kanë të bëjnë me:

Hartimi dhe zbatimi i programit të trajnimit, programit mësimorë të kurrikulave mësimore dhe të akteve administrative të nevojshme lidhur me “*njohjen dhe respektimin/garantimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe në veçanti për personat që ju është privuar liria në ambjentet e policisë (personat e shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar)*”.

Sipas Programit të Punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit afati i përfundimit të trajnimit është muaji Prill 2012, por sipas plan-veprimeve në Drejtorinë e Policisë së Qarqeve ky proces nuk ka përfunduar dhe se është në vazhdim.

Trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia:

Në të gjitha komisariatet e policisë libri i shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të shtetasve nuk ishte ndërtuar ende sipas Urdhërit nr.158, date 12.04.2012 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pasi hapësira e rubrikave nuk është sipas këtij urdhëri. Ndërsa në disa komisariate (Komisariatit e Policisë Kurbin etj) nuk ka libër për personat e ndaluar/arrestuar dhe të gjitha shënimet për këta persona bëhen në librin e personave të shoqëruar. Grupet e punës kanë përfunduar modelin e ri të librit të shoqërimit dhe ndalim/arrestimit. Nga verifikimet në vend konstatohet se libri është në proces prodhimi.

Në librin aktual të të shoqëruarve dhe ndaluarve/arrestuarve, konstatohet se disa prej rubrikave jo gjithmonë plotësoheshin sipas kërkesave të ligjit.

-Në rubrikën e njoftimit të familjarëve nuk pasqyrohej saktë, emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që është njoftuar si dhe fakti i shoqërimit, ndalimit apo arrestimit. Kujtojmë se, njoftimi i familjarëve të të shoqëruarit, ndaluarit dhe arrestuarit për ndodhjen e tij në polici dhe arsyet ligjore, përbën detyrim ligjor për punonjësit e policisë, i cili është parashikuar në nenin 107 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

-Në rubrikën ku flitet për adresën e të shoqëruarit, ndaluarit apo arrestuarit nuk pasqyrohet saktë vendbanimi i tij.

-Në rubrikën ku flitet për arsyet e shoqërimit vërehet se, në shumicën e rasteve personat e shoqëruar ishin si të dyshuar për kryerjen e një vepre penale si, vrasje, vjedhje, kanosje, plagosje, kundërshtim të punonjësve të policisë, persona që janë në kërkim, persona për shkak të konflikteve midis tyre, për prishje rendi, për dhunë në familje, verifikim etj. Trajtimi i të dyshuarit për kryerje të një vepre penale si të shoqëruar vjenë në kundërshtim me nenin 11 pika 6 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” në të cilin shprehimisht thuhet se “Shoqërimi, në kuptimin e këtij ligji, nënkupton rastin kur një person ka shkelur një rregull administrativ dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqërimit në zyrat e policisë me ose pa vullnetin e tij” dhe jo kur ai është i dyshuar si autor i një vepre penale dhe aq më tepër kur personi është arrestuar në flagrancë.

Avokati i Popullit në datën 07 dhe 12.06.2012 kreu një sondazh në komisariatet Lezhë dhe Mirditë nga i cili rezultoi si më poshtë:

a.Në Komisarlatin e Policisë Lezhë, për periudhën 09.05.2012 deri në datën 05.06.2012 ishin trajtuar si të shoqëruar 10 shtetas të cilët më pas ishin ndaluar apo arrestuar. Koha e trajtimit të tyre si të shoqëruar shkonte 67 orë (privim lirie i paligjshëm) ose 6 orë e gjysëm për çdo person.

b.Në Komisarlatin e Policisë Mirditë, për periudhën 02.02.2012 deri në datën 04.06.2012 ishin trajtuar si të shoqëruar 14 shtetas të cilët më pas ishin ndaluar apo arrestuar. Koha e trajtimit të tyre si të shoqëruar shkonte 102 orë (privim lirie i paligjshëm) ose 7 orë për çdo person. Duhet theksuar se në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit nuk vihej çasti (ora) e kapjes në fakt, por ora e përpilimit të procesverbalit. Bazuar në nenet 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Grupet e punës kanë përfunduar modelin e ri të librit të shoqërimit dhe ndalim/arrestimit si dhe hapjen e një libri lidhur me ankesat e personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar. Nga verifikimet në vend konstatohet se libri është në proces prodhimi.

Gjatë vitit 2012 do të kryhen inspektive nga ekspertë të Avokatit të Popullit për të verifikuar në vend zbatimin e rekomandimeve sipas afateve të përcaktuara në planin e punës të D.P.P.Sh

Kontrolli personal dhe marrja e gjurmëve daktiloskopike.

Të shoqëruarve ju bëhet në çdo rastë kontrolli personal si dhe ju merren gjurmët daktiloskopike. Në datën 08.01.2011, në Komisarlatin e Policisë Fier janë trajtuar si të till vetëm për një ditë 34 persona.

Sqarojmë se kontrolli i personave të shoqëruar është shkelje e hapur e të drejtës kushtetuese të paprekshmërisë personale të personit. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 37/3 të Kushtetutës tonë, ku thuhet se: “Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik”.

Njëkohësisht ky veprim vjen në kundërshtim edhe dispozitat e K.Pr.Penale dhe konkretisht me nenet 202 e vijues, të cilat parashikojnë kontrollin e personit. Neni 202 i K.Pr.Penale parashikon se:

“Kur ka arësye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale, gjykata merr vendim për kontrollin personal....

Në rast flagrante ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur dhe që nuk lejohet nxjerrjen e një vendimi kontrolli, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 299”.

Ndërsa marrja e gjurmëve të shoqëruarëve vjen në kundërshtim me nenin 103 të ligjit. Në pikën 5 të këtij neni është parashikuar e drejta e policisë, që mund të marrë shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve personit të shoqëruar, por vetëm në rastin nëse këto të dhëna nevojiten për të përcaktuar identitetin e personit.

Është me rëndësi që të theksojmë se ky veprim vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me nenin 6 të ligjit nr. 9887, dt. 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, sipas të cilit përpunimi i të dhënave personale të një personi fizik (pjesë e të cilit është edhe marrja e tyre) kushtëzohet me dhënien e pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave personale.

Ndihma juridike dhe psikologjike:

Gjatë inspektimit janë konstatuar raste që të ndaluarit/arrestuarit madhorë që nuk kanë mundësi financiare për të pajtuar një avokat privat dhe kërkojnë ndihmë juridike janë pyetur pa praninë e mbrojtësit. Komisaritet e Policisë Lushnje dhe nr.2 Tiranë.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit e mitur, për të cilët ndihma juridike dhe psikologjike është e detyrueshme, konstatohet se, në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut, është parashikuar një specialist psikolog, por gjatë inspektimeve rezulton se jo në çdo rast psikologu është me arsimin përkatës dhe se në disa raste ai ka disa funksione si zëdhënës, statisticient, jurist etj (Drejtoria e Policisë Fier, Lezhë, Korçë etj). Veprimet e mësipërme vijnë në kundërshtim me nenet 35, 49 dhe 255/1 të K.Pr.Penale.

Trajtimi me ushqim

Në disa Komisariate Policie të ndaluarit/arrestuarit nuk trajtohen me ushqim sipas kërkesave të Manualit “*Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*”, në të cilat shprehimisht thuhet se: “ *Trajtimi me ushqim i të arrestuarve/ndaluarve bëhet sipas normave të përcaktuara e miratuara nga Ministra e Brendëshme dhe Ministria e Shëndetsisë.....Përgatitja dhe gatimi i ushqimit bëhet në ambiente të posaçme (guzhina) të drejtorive/komisariateve të policisë ose në ambientet e subjekteve private të kontraktuara për këtë qëllim. Të tillë mund të përmëndim Komisariatet e Policisë Kavajë, Lezhë Porgadec etj*

Trajtimi mjekësor

Të ndaluarve/arrestuarve ju bëhej kontrolli mjekësor sipas kërkesave të ligjit (brenda 24 orëve) shoqëruar me kartelën mjekësore për secilin. Në organikën e Drejtorisë të Policisë së Qarkut Lezhë ka një mjek të përgjithshëm i cili ka një ambient (dhomë) të përshtatëshme për të bërë vizita. Medikamentet e kutisë së ndihmës së shpejtë siguroheshin në mënyrë të vazhdueshme me fondet e Drejtorisë së Policisë. Ambulancë për rast urgjence apo për rastet kur policia kryen operacione policore nuk ka.

Të ndaluarit/arrestuarit nuk kanë mundësi të komunikojnë me telefon me familjarët pasi në ambientet e sigurisë nuk ishte vendosur telefon. Ky komunikim shpesh behet nga punonjësit e policies me telefonin dhe shpenzimet e tyre.

Transferimin nga ambientet e policisë

Konstatohet se të paraburgosurit, ndaj të cilëve është vendosur masa e sigurimit “*arrest në burg*” dhe e të ndaluarve për efekt të ekzekutimit të vendimit penal të denimit të tyre në mungesë me burgim vazhdojë të qëndrojnë për një kohë ta gjatë në ambientet e sigurisë së Komisariateve të policisë. Komisariati i Policisë Lushnje.

Brenda ambienteve të shoqërimit dhe të sigurisë nuk janë të vendosura posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar.

Në lidhje me ndryshimet legislative, nga ana e grupit të D.P.P.Sh janë marrë në konsideratë propozimet për ndryshimin e ligjit “*Për Policinë e Shtetit*”, dhe pritet përgatitja e projektligjit për ta përcjellë atë në Komisionin Parlamentar për Sigurinë.

Gjatë vitit 2012 do të kryhen inspektime nga ekspertë të Avokatit të Popullit për të verifikuar në vend zbatimin e rekomandimeve sipas afateve të përcaktuara në planin e punës të D.P.P.Sh.

VI. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të vlerësimeve të sipërpërmendura dhe të problematikave të konstatuara gjatë veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit për periudhën janar-qershor 2012, mendojmë se procesi i integritit të Shqipërisë në BE, kërkon një angazhim të të gjithë aktorëve dhe faktorëve të shtetit shqiptar.

Perspektiva e Integritit të Shqipërisë në BE, duhet të jetë në themel të orientimit të të gjitha politikave, nismave ligjore dhe nënligjore, apo dhe aktiviteteve të të gjitha institucioneve shtetërore dhe insitucioneve të pavarura kushtetuese.

1.Lidhur me masat e **rekomandimit 6 “Reforma në administratën publike”**, projektligji “Për statusin e nëpunësit civil”, duhet t’i paraqitej Kuvendit në qershor 2012.

Përsa i përket masës që lidhet me paraqitjen e një raport për zbatimin e vendimeve të KSHC dhe të vendimeve të gjykatave për nëpunësit e shërbimit civil, parashikuar për në prill 2012, në raportet e vendosura në faqen e Ministrisë së Integritit European për zbatimin e masave të Planit të Veprimit për 12 rekomandimet e BE (për deri në fund të muajit maj 2012), zbatimi i një mase të tillë nuk është raportuar. Po kështu në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike nuk ka të publikuar një raport të tillë.

2. Për **rekomandimin 7 “Reforma në drejtësi”**, dhe masën e parashikuar për zbatimin efektiv të ligjit të ndihmës juridike, konstatojmë se ka patur zhvillime pozitive në drejtim të miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit, si dhe është vendosur për ofrimin e ndihmës juridike për disa kërkesa të paraqitura pranë Komitetit Shtetëror të Ndihmës Juridike. Pavarësisht kësaj, mendojmë së ende ka vend për funksionimin me efektivitet dhe transparencë të Komisionit Shtetëror të Ndihmes Juridike për rritjen e numrit të rasteve që ofrohet ndihma juridike parësore apo dytësore, sidomos për grupe të tilla si, romët, personave me aftësi të kufizuara.

3. Përsa i përket **rekomandimit 10 “Strategjia dhe Plani i Veprimit për të Drejtën e Pronës”**, Këshilli i Ministrave ka vendosur në mbledhjen e tij të datës 27.06.2012, miratimin e strategjisë ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012 - 2020” dhe të planit të saj të veprimit.

Në këtë rekomandim gjithashtu mendojmë se duhet evidentuar në mënyrë të veçantë shtyrja në kohë e realizimit të detyrimeve të parashikuara në VKM 350/2011, apo problematika e zbatimit të disa vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

4. Për rekomandimin 11 “Mbrojtja e të drejtave të njeriut”:

a. Lidhur me masën “Vendosja e mekanizmit kombëtar të referimit për luftën ndaj viktimave të dhunës në familje”, konstatojmë se Vendimi i Këshillit të Ministrave për vendosjen e këtij mekanizmi ka hyrë në fuqi prej muajit mars 2011, por ende nuk janë ngritur dhe konstituar në të gjithë vendin këto mekanizma.

b. Përsa i përket të drejtave të Komunitetit LGBT dhe masës 11.2.3 “Zhvillim i një programi konkret pune, aktiviteteve sensibilizuese për personat LGBT”, parashikuar për në mars 2012, programi i punës nuk është ende i miratuar nga Këshilli i Ministrave. Projektplanin i diskutuar nuk përmban në brendinë tij, masa, indikatorë dhe buxhete të mjaftueshme për realizimin e një objektivi apo politikave të caktuara.

c. Lidhur me të drejtat e fëmijëve është miratuar nga Këshilli i Ministrave Plani i Veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve 2012-2015, si dhe aktet nënligjore në zbatim të ligjit (megjithëse jashtë afatit të përcaktuar në Plan. Megjithëse janë miratuar aktet nënligjore për Këshillin Kombeëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, por megjithëse ka kaluar një vit, Këshilli nuk është mbledhur asnjëherë.

Gjithashtu nuk janë shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, mekanizmat e referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik.

d. Lidhur me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, vendosjen e një kalendarit për miratimin e ligjit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe për ratifikimin e Konventës së OKB. Pavarësisht kësaj mase, konstatojmë se hapat dhe fazat që po ndiqen për diskutimin dhe miratimin e këtyre akteve të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara janë të ngadalta, duke ndikuar në këtë mënyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë në garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe kapërcimin e problematikave me të cilat ata ndeshen.

e. Përsa i përket të drejtave të minoritetit rom, nuk ka ende të miratuar nga Këshilli i Ministrave një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të seminarit (të z. Pier Mirel) të dhjetorit 2011 “Për të drejtat e minoritetit rom”, ndërkohë që problematikat me të cilat ndeshen këta qytetarë janë të shumta duke filluar nga regjistrimi, strehimi, punësimi, arsimimi, përfitimi i ndihmës ekonomike etj.

5. Lidhur me rekomandimin 12 “Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit për trajtimin e të ndaluarve dhe të dënuarve në burgjet, paraburgim dhe komisaritatet e policisë”:

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka hartuar Programin e Punës për përmbushjen e rekomandimeve të Avokatit të Popullit si dhe ka ngritur grupin e punës për ndjekjen dhe zbatimin e detyrave në përmbushje të këtyre rekomandimeve. Në programin e punës përcaktohen masa dhe detyra konkrete që duhet të merren për realizimin e rekomandimeve të Komisionit Europian dhe të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur mendimet e saj lidhur me raportin e veçantë të përgatitur nga institucioni i Avokatit të Popullit për zbatimin e rekomandimit 12 të BE, ndërkohe vërehet një mungesë bashkëpunimi dhe reagimi ndaj rekomandimeve dhe masave të propozuara nga institucioni ynë.

Për zgjidhjen e çështjeve të sipërpërmendura rekomandojmë:

1. Ndjekjen dhe mbikqyrja në vazhdimësi nga Departamenti i Administratës Publike, i procedurave që ndiqen në zbatim të ligjit për statusin e nëpunësit civil, si dhe i zbatimit të vendimeve të KSHC dhe të gjykatave për nëpunësit civil.

2. Zbatimin me efektivitet dhe transparencë të Komisionit Shtetëror të Ndihtes Juridike, në drejtim të procedurave që kryhen, për rritjen e numrit të rasteve që ofrohet ndihma juridike parësore apo dytësore, sidomos për grupe të tilla si, romët, personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu të vlerësohet mundësia e lehtësimit të procedurave dhe të dokumentacionit që paraqitet për përfitimin e ndihmës juridike, si dhe monitorimi nga Komisioni Shtetëror i Ndihtes Juridike i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar nga Avokatët apo Organizatat Jofitimprurëse,

si një element shumë i rëndësishëm për garantimin dhe dhënien e drejtësisë ndaj cilitdo që pretendon se i është shkelur ajo.

3.Zbatimi i Strategjisë së ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë, 2012 - 2020” dhe të planit të saj të veprimit, miratimi i akteve nënligjore të parashikuara në VKM 350/2011, si dhe ndjekja dhe zbatimi në vazhdimësi i vendimeve të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

4.Vendosja dhe shtrirja në të gjithë territorin e RSH, i mekanizmit kombëtar të referimit për luftën ndaj viktimave të dhunës në familje.

5.Miratimin e programit të punë, me aktivitete sensibilizuese për personat LGBT, duke parashikuar në brendinë tij, masa, indikatorë dhe buxhete të mjaftueshme për realizimin e një objektivi apo politikave të caktuara.

6.Të mblidhet Këshillin Kombeëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, me qëllim konsultimin, diskutimin dhe koordinimin e politikave, legjislacionit dhe aktiviteteve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Të shtrihen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, mekanizmat e referimit të rasteve të fëmijëve në rrezik.

7. Të vendoset një kalendar për miratimin e ligjit për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe për ratifikimin e Konventës së OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Në këtë kalendar të ketë aktivitete konkrete për diskutimin e këtyre nismave jo vetëm me autoritetet shtetërore përgjegjëse dhe institucionet e pavarura kushtetuese, por edhe me vetë personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat që i përfaqësojnë ata.

8.Të miratohet nga Këshilli i Ministrave një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të seminarit (të z. Pier Mirel) të dhjetorit 2011 “Për të drejtat e minoritetit rom”, si dhe të ndërmerren në zbatim të rekomandimeve të Avokatit të Popullit masa ligjore dhe zbatuese për zgjidhjen e problematikave me të cilat ndeshen qytetarët romë, duke filluar nga regjistrimi, strehimi, punësimi, arsimimi, përfitimi i ndihmës ekonomike etj.

9. Monitorim i vazhdueshëm për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për trajtimin e të ndaluarve dhe të dënuarve në burgjet, paraburgim dhe komisaritatet e policisë.

Në përfundim dëshirojmë të theksojmë, që konkluzionet dhe rekomandimet e sipërcituara do të jenë objekt i vlerësimeve dhe analizave të mëtejshme nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile të cilë bashkëpunojnë me institucionin tonë.

Gjithashtu Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e parashikuara në ligj, do të vazhdojë aktivitetin e tij në drejtim të përmirësimit të situatës së zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit për zbatimin e 12 rekomandimeve të BE për Shqipërinë, duke dhënë edhe kontributin e tij lidhur me këto çështje.